

deri në detyrën e Komandantit të Batalionit me Gradën “Major”. Më datë 11 Janar 1996 është nxjerrë në lirim nga reforma në ushtri.

Pra e gjithë karriera e tij e punës së tij, ka qënë puna në ushtri si oficer aktiv dhe si instruktor për problemet ushtarake në periudhën që ka punuar në sektorin ushtarak të Aparatit të KQ të BRPSH-së.

Duke u bazuar në këtë vjetërsi shërbimi, siç jemi shprehur gjatë korrespondencës së kryer për këtë rast, është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi deri në muajin Tetor 2014.

Nga dokumentacioni që na keni dërguar, konstatojme se në *Modularin e Vjetërsisë së Shërbimit si Ushtarak Aktiv për efekt të sigurimeve shoqërore suplementare më datë 05.07.2007*, në pjesën, *Koha e shërbimit aktiv në ushtri*, është njohur periudha 20.03.1981-04.06.1991 si vjetërsi shërbimi.

Referuar akteve nënligjore që kanë qënë në fuqi në momentin që shtetasit L.D i ka lindur e drejta për përfitim, rezulton se:

-Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.48 datë 05.02 1991 “*Për njohje vjetërsie të shërbimit ushtarak*” thuhet shprehimisht se:

“Gjithë instruktorëve të Aparatit të Komitetit Qendror të PPSH dhe të aparateve të komiteteve të Partisë në rrethe,që kanë ardhur nga njësitë e repartet e Ministrisë së Mbrojtjes e të Punëve të Brendshme e që mbulojnë veprimtarinë e këtyre organeve,t’ju njihet si vjetërsi e shërbimit ushtarak për efekt pensioni,koha e punës në këto aparateve”.

Pra, ky akt nënligjor ka rregulluar situatën e ish-ushtarakëve, të cilët kanë punuar në institucionet e lartpërmendura, me qëllim njohjen e periudhës së punës së tyre si vjetërsi në shërbimin ushtarak.

Shtetasi L.D, ka qënë ushtarak dhe ka punuar në Aparatin e Komitetit Qendror të BRPSH-së, sektori ushtarak, që ka qënë strukturë brenda ish Komitetit Qendror të PPSH-së.

Njohja e vjetërsisë në shërbimin ushtarak është përcaktuar edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 225 datë 29.05.1992 “*Për trajtimin financiar të ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura*”, ku në pikën 4/d , thuhet se,

“...4. Për efekt të caktimit të pagës mujore, oficerëve, nënoficerëve dhe policëve aktivë në vjetërsinë e shërbimit ushtarak, llogaritet:

...d) Koha a kaluar për nevoja pune e shërbimi në organet shtetërore ose në organizmat politiko-shoqërore në interes të mbrojtjes”.

Ky vendim është nxjerrë për riorganizimin e Forcave të Armatosura si pasojë e reformës së kryer në ushtri në atë kohë, duke përfshirë oficerët, nënoficerët dhe

policët e shërbimit aktiv, që deri më datë 30.08.1993 mbushin moshën 50 vjeç..... si dhe ato që mund të nxirren në lirim me urdhër të ministrit ose të drejtorit të SHIK-ut, edhe me moshë më të ulët se 50 vjeç, për burra, *por nga ana tjetër është pranuar fakti se periudha e punës në organet shtetërore ose në organizmat politiko-shoqërore, në interes të mbrojtjes (ku ka punuar edhe ankuesi) njihet si vjetërsi në shërbimin ushtarak.*

Pavarësisht se shtetasi L. D, nuk është i përfshirë si përfitues i këtij vendimi, duke qenë se periudha e punës në organet shtetërore ose në organizmat politiko-shoqërore në interes të mbrojtjes, është njohur si vjetërsi në shërbim ushtarak, për analogji edhe kategoritë e ish-ushtarakëve që nuk kanë moshën e përcaktuar në këtë vendim, kjo periudhë pune duhet të njihet si vjetërsi në shërbim.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku thuhet se : "*Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*",

REKOMANDOJMË:

Njohjen e periudhës së punës 20.03.1981-04.06.1991 në ish-Komitetin Qendror të BRPSH-së, në sektorin ushtarak, si vjetërsi shërbimi, për shtetasin L.D.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*", lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI